BEKAMENT®

Fuqia është në duart tona

CLASSIC

PRODUKTET PËR SUVATIM ME MAKINË

KATALOGU

FUQIA ËSHTË NË DUART TONA

BEKAMENT®

CLASSIC

PRODUKTET PËR SUVATIM ME MAKINË

SIPËRFAQE

LLAÇ DORE DHE MAKINE

BEKAMENT®

Fuqia është në duart tona

BK-Nivelator

Bazë për sipërfaqet me thithshmëri jo të njëtrajtshme

Përdorimi: Masë lyerëse që ka për qëllim nivelimin dhe neutralizimin e sipërfaqeve me thithshmëri jo të njëtrajtshme siç janë gaz betoni, tullat, guri poroz etj. Përdoret si bazë tek sipërfaqet me thithshmëri të lartë para suvatimit me suva çemento-gëlqerore dhe allçi-gëlqerore me qëllim që të parandalojë tharjen jo të njëtrajtshme dhe plasaritjen e suvasë, si dhe para patinimit me glet masat.

Përgatitja dhe vendosja: Sipërfaqja në të cilën vendoset masa lyerëse duhet të jetë e fortë, e thatë dhe e pastruar nga pluhuri. BK-Nivelator përgatitet duke e holluar me ujë në një raport 1:6 deri 1:10 (lyerës:ujë) në varësi të thithshmërisë së sipërfaqes. Për sipërfaqet me thithshmëri të lartë duhet holluar më pak. Masa aplikohet me rrul, furçë ose spërkatës. Në rastin e sipërfaqeve me thithshmëri të lartë mund të bëhet aplikim i dyfishtë sipas parimit e njomë në të njomë. Për udhëzime më të detajuara shikoni fletën teknike të produktit.

Temperatura e përdorimit: Nga +5°C deri +30°C. Të mos punohet direkt në diell, shi dhe erë të fortë.

Shpenzimi: Rreth 0,030-0,060 kg/m², në varësi të thithshmërisë së sipërfaqes.

Kohëzgjatja dhe ruajtja: 18 muaj në paketimin origjinal. Të ruhet në temperaturën nga +5°C deri +25°C, e mbrojtur nga drita e diellit dhe ngrirja.

Paketimi: 10 i 20 kg

I barazon dhe i neutralizon sipërfaqet me absorbim të lartë

I zvogëon sipërfaqet absorbuese

E vazhdon kohën e hapur për shtresat e ardhshme

BK-Beton Kontakt

Bazë strukturore për sipërfaqe të lëmuara

Përdorimi: Bazë stukturore që ka për qëllim rritjen dhe njëtratshmërinë e aftësisë ngjitëse tek sipërfaqet me thithshmëri të ulët, të lëmuara dhe me dendësi të madhe, para suvatimit me suva çemento-gëlqerore dhe allçi-gëlqerore. BK-Beton Kontakt rekomandohet sidomos për betonet e lëmuar, si dhe për sipërfaqet betoni të gatshme fabrikisht. Përdoret edhe si bazë tek sistemi i ngjitjes së pllakës mbi pllakë.

Pëgatitja dhe vendosja: Sipërfaqja në të cilën vendoset BK-Beton Kontakt duhet të jetë e fortë, e thatë dhe e pastruar nga pluhuri. BK-Beton Kontakt duhet të homogjenizohet mirë para së të përdoret dhe, nëse është e nevojshme, të hollohet me një sasi të vogël ujë (deri në 1%). Astari aplikohet mbi sipërfaqen e murit me rul ose furçë me qime të gjata në një shtresë. Është e mundshme edhe vendosja me makineri me pajisje të përshtatshme. Koha e nevojshme e tharjes deri në vendosjen e suvasë është min.4 orë. Për udhëzime më të detajuara shikoni fletën teknike të produktit.

Temperatura e përdorimit: Nga +5°C deri +30°C. Të mos punohet direkt në diell, shi dhe erë të fortë.

Shpenzimi: Rreth 0.5 kg/m².

Kohëzgjatja dhe ruajtja: 18 muaj në paketimin origjinal. Të ruhet në temperaturën nga +5°C deri +25°C, e mbrojtur nga drita e diellit dhe ngrirja.

Paketimi: 6 i 20 kg

E rritë vrazhdësinë e bazamentit

Përmirëson aderimin

BK-Mal 420

Suva çimento-gëlqerore e përforcuar për mure të jashtme

Përdorimi: Suva çemento-gëlqerore e përforcuar për përdorim me makineri dhe me dorë në muret e jashtme dhe të brendshme me tulla, blloqe, blloqe siporeks dhe beton. Produkti mund të përdoret për objektet sanitare si dhe për sipërfaqe në të cilat do të vendoset qeramika. Produkti karakterizohet me fortësi të lartë mekanike dhe ngjitshmëri të mirë mbi bazën, prandaj kjo lloj suvaje është e përshtatshme sidomos atje ku do të vendosen më vonë elemente të rënda.

Përgatitja dhe vendosja: Sipërfaqja në të cilën vendoset suvaja duhet të jetë e fortë, e pastër dhe e thatë, pa pjesë të lidhura jo mirë dhe njolla yndyre. Mbyllja e vrimave, fugave, hapjeve elektrike duhen përfunduar para fillimit të suvatimit. Në rast suvatimi sipërfaqesh betoni ose sipërfaqesh të tjera të lëmuara është e nevojshme që në sipërfaqe të vendoset BK-Beton Kontakt me qëllim që të përmirësohet ngjitja e suvasë. Në rastet kur sipërfaqja ka thithshmëri të lartë ose është poroze (psh. blloqet siporeks) është e nevojshme që në sipërfaqe të vendoset BK-Nivelatori për të evituar tharjen jo të njëtrajtshme dhe plasaritjen e suvasë. Në qoftë se sipërfaqja ka shumë pabarazi, duhet të vendoset fillimisht BK-Mal 120. Përgatitja e suvasë realizohet me përzierje intensive të pluhurit me rreth 22-24% ujë. Suvaja më së shpeshti vendoset në dy faza, me metodën e freskët në të freskët, në bazën e përgatitur paraprakisht të thatë me trashësi min. 10 mm, kurse maks. 25 mm. Pastaj suvaja të shtrihet me qepër-H, të përpunohet dhe të rrafshohet. Ku janë të nevojshme trashësi më të mëdha të suvasë është e nevojshme që ajo të vendoset në kontinuitet sipas parimit e njomë në të njomë deri sa të arrihet trashësia e nevojshme (max. 40 mm).

Kushtet atmosferike optimale: temperatura e sipërfaqes dhe e ajrit +5°C deri +25°C. Suvaja duhet të forcohet në mënyrë të barabartë. Ngrohja direkte e suvasë nuk rekomandohet. Për udhëzime më të detajuara shikoni fletën teknike të produktit.

Shpenzimi: Rreth 12-13 kg/m²/cm trashësi.

Kohëzgjatja dhe ruajtja: 12 muaj në paketimin origjinal në ambient të thatë në paleta.

Paketimi: 30 kg.

Për përdorim të jashtëm

Punueshmëri e jashtëzakonshme

Ngjitje e shkëlqyer

Klasi CS II W1 sipas standardit EN 988-1

BK-Mal 320

Suva allçi-gëlqerore për mure të mbrendshme

Përdorimi: Suva allçi-gëlqerore për përdorim me makineri dhe me dorë në muret e brëndshëm me tulla, blloqe, blloqe siporeks dhe beton. Produkti nuk mund të përdoret për objektet sanitare si dhe për sipërfaqe në të cilat do të vendoset qeramika.

Përgatitja dhe vendosja: Sipërfaqja në të cilën vendoset suvaja duhet të jetë e fortë, e pastër dhe e thatë, pa pjesë jo të lidhura mirë dhe njolla yndyre etj. Mbyllja e vrimave, fugave, hapjeve elektrike duhen përfunduar para fillimit të suvatimit. Në rast suvatimi sipërfaqesh betoni ose sipërfaqesh të tjera të lëmuara është e nevojshme që në sipërfaqe të vendoset BK-Beton Kontakt me qëllim që të përmirësohet ngjitja e suvasë. Në rastet kur sipërfaqja ka thithshmëri të lartë ose është poroze (blloqet siporeks) është e nevojshme që në sipërfaqe të vendoset BK-Nivelatori për të evituar tharjen jo të njëtrajtshme dhe plasaritjen e suvasë. Përgatitja e suvasë realizohet me përzierje intensive të pluhurit me rreth 30% ujë. Suvaja të vendoset me makineri me një trashësi minimum 10 mm, e maksimum 25 mm. Pastaj suvaja të shtrihet me qepër-H, të përpunohet dhe të rrafshohet. Ku janë të nevojshme trashësi më të mëdha të suvasë është e nevojshme që ajo të vendoset në kontinuitet sipas parimit e njomë në të njomë deri sa të arrihet trashësia e nevojshme (max. 40 mm). Suvaja duhet të forcohet në mënyrë të barabartë. Ngrohja direkte e suvasë nuk rekomandohet. Për udhëzime më të detajuara shikoni fletën teknike të produktit.

Shpenzimi: Rreth 11-12 kg/m²/cm trashësi.

Kohëzgjatja dhe ruajtja: 12 muaj në paketimin origjinal në ambient të thatë në paleta.

Paketimi: 30 kg

Për përdorim të brendshëm

Punueshmëri e shkëlqyer

Ngjitje e shkëlqyer

BK-Mal 220

Suva çemento-gëlqerore për mure të mbrendshme

Përdorimi: Suva çemento-gëlqerore për përdorim me makineri ose dorë në muret e brëndshme me tulla, blloqe, blloqe siporeks dhe beton. Produkti mund të përdoret për objektet sanitare si dhe për sipërfaqe në të cilat do të vendoset qeramika.

Përgatitja dhe vendosja: Sipërfaqja në të cilën vendoset suvaja duhet të jetë e fortë, e pastër dhe e thatë, pa pjesë të lidhura jo mirë dhe njolla yndyre. Mbyllja e vrimave, fugave, hapjeve elektrike duhen përfunduar para fillimit të suvatimit. Në rast suvatimi sipërfaqesh betoni ose sipërfaqesh të tjera të lëmuara është e nevojshme që në sipërfaqe të vendoset BK-Beton Kontakt me qëllim që të përmirësohet ngjitja e suvasë. Në rastet kur sipërfaqja ka thithshmëri të lartë ose është poroze (psh. blloqet siporeks) është e nevojshme që në sipërfaqe të vendoset BK-Nivelatori për të evituar tharjen jo të njëtrajtshme dhe plasaritjen e suvasë. Në qoftë se sipërfaqja ka shumë pabarazi, duhet të vendoset fillimisht BK-Mal 120. Përgatitja e suvasë realizohet me përzierje intensive të pluhurit me rreth 22-24% ujë. Suvaja të vendoset me makineri me një trashësi minimum 10 mm, e maksimum 25 mm. Pastaj suvaja të shtrihet me qepër-H, të përpunohet dhe të rrafshohet. Ku janë të nevojshme trashësi më të mëdha të suvasë është e nevojshme që ajo të vendoset në kontinuitet sipas parimit e njomë në të njomë deri sa të arrihet trashësia e nevojshme (max. 40 mm). Suvaja duhet të forcohet në menyrë të barabartë. Ngrohja direkte e suvasë nuk rekomandohet. Për udhëzime më të detajuara shikoni fletën teknike të produktit.

Shpenzimi: Rreth 12-13 kg/m^2/cm trashësi.

Kohëzgjatja dhe ruajtja: 12 muaj në paketimin origjinal në ambient të thatë në paleta.

Paketimi: 30 kg

Për përdorim të brendshëm

I përshtatshëm për hapësirat e lagështa

Klasi CS I W1 sipas standardit EN 12004

BEKAMENT®

Fuqia është në duart tona

Banja Komerc Bekament DOO
Arandjelovac, 34304 Banja, Serbia
Tel: +381 34 6777 500; Faks: +381 34 6777 506
www.bekament.com